



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1504/ 7 prot.

Datë 30.07.2025

V E N D I M
Nr. 981/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-44826-04-12-2025, me objekt: “Blerje e artikujve ushqimorë”, me fond limit 22,354,848 (njëzet e dy milion e treqind e pesëdhjetë e katërmijë e tetëqind e dyzet e tetë) lekë pa tvsh, ose 224,739.59 (dyqind e njëzet e katërmijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e nentë) Euro, zhvilluar më datë 15.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, me NIPT J66902033R dhe J71601012S, me adresë Rruga “Pal Engjëlli”, Lagjia “Tre Heronjt”, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik..

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.04.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-44826-04-12-2025, me objekt: “*Blerje e artikujve ushqimorë*”, me fond limit 22,354,848 (*njëzet e dy milion e treqind e pesëdhjetë e katërmijë e tetëqind e dyzet e tetë*) lekë pa tvsh, ose 224,739.59 (*dyqind e njëzet e katërmijë e shtatëqind e tridhjetë e nënte pikë pesëdhjetë e nentë*) Euro, zhvilluar më datë 15.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 15.05.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 21.05.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë

pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK	19,395,650	lekë skualifikuar
2. “Sead SGS” SHPK	22,266,682	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 21.05.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

1- Kontrata e bashkepunimit mes paleve nr.983 rep date 14.05.2025 nuk eshte bere ne respektim te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 ku thuhet: Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve, pasi ne kontraten e bashkepunimit eshte bere vetem ndarja ne perqindje 10% me 90% ndermjet subjekteve por nuk jane percaktuar elementet konkrete pasi nuk eshte percaktuar se cilet artikuj konkretisht merr persiper te furnizojë njera pale dhe pala tjetër pjesë e akt/marreveshjes. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimit ku ne faqen e dyte parashikohet “Nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatorësh Ekonomike, do te paraqitet marrreveshje bashkepunimi ku caktohet.....dhe elementet qe merr persiper secili prej anetareve te bashkimit”.

2- Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit te shoqerise Nelsa eshte deklaruar ne seksionin e subjekteve mbeshtetes shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k e cila ne dokumentat e tenderit eshte deklaruar si anetare e bashkimit te operatorëve duke mos plotësuar keshtu kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e sakta më sipër sic ky formular parashikon. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimit ku ne faqen e dyte rreshti i parë theksohet se “Ne rast bashkimi te operatorëve , secili anetar i grupit duhet te paraqese Vetedeklarimin e lartpermendur”, si dhe me poshte “Nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatorësh Ekonomike, do te paraqitet marrreveshje bashkepunimi ku caktohet perfaqesuesi, perqindja e pjesmarrjes ne bashkim.....”.

3- Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit te shoqerise Nelsa sh.p.k eshte paraqitur vetem nje mjet jo frigoriferik ATO me targa AA 978 KU dhe nuk eshte deklaruar mjeti frigoriferik sipas kerkesave te DST ku ofertuesit duhet te disponojne 2 (dy) mjete APV dhe ATP kjo gje bie ne kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3 ku thuhet: Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Pra sic parashikohet ne piken 2.3.7 “Subjekti

ofertues duhet te kete ne pronesi ose me qera, nepermjet aktit te pronesise ose kontrates noteriale...2 mjete APV dhe ATP... ”.

4- Shoqeria Nelsa nuk ka paraqitur flete analiza ne raport me perqindjen e pjesemarrjes ne bashkimin e operatoreve ekonomike pamvaresisht faktit se ne kontraten e bashkepunimit thuhet se fleteanalizat realizohen nga shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k. por kjo gje bie ne kundershitim me VKM Nr. 285, date 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 3 ku thuhet: Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

II.5. Në datën 02.06.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesin paraprak në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në datën 11.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5410 dhe me numër 1504/2025 prot., datë 11.06.2025 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “El-Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë vijon:

Referuar vlerësimit të kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se oferta e shoqërisë tonë e cila bazuar në kontratën e bashkëpunimit me Nr. Rep 983, Nr. Kol 560, datë 14.05.2025 është paraqitur si bashkim operatorësh midis operatorëve “El-GJO 2006” Shpk dhe “Nelsa” Shpk, është e skualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në fakt ndërkohë që rezulton e kualifikuar oferta e një operatori tjetër ekonomik i cili ka dorëzuar një ofertë me një vlerë rreth 13% më të lartë se oferta e shoqërisë sonë, duke sjellë në këtë mënyrë një dëm ekonomik të konsiderueshëm për fondet e “Bashkisë Shkodër”. Në rastin konkret oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë “El-GJO 2006” Shpk dhe “Nelsa” Shpk është e skualifikuar me pretendimin se: “1- Kontrata e bashkepunimit mes paleve nr. 983 rep date 14.05.2025 nuk eshte bere ne respektim te VKM Nr. 285, date 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike, pika 1 ku thuhet: Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një Kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve, pasi ne kontraten e bashkepunimit eshte bere vetem ndarja ne perqindje 10% me 90% ndermjet subjekteve por nuk jane percaktuar elementet konkrete pasi nuk eshte percaktuar se cilet artikuj konkretisht merr persiper te furnizojë njera pale dhe pala tjeter pjese e akt/marreveveshjes. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimi ku ne faqen e dyte parashikohet “nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatoresh Ekonomike, do te paraqitet marrreveveshje bashkepunimi ku caktohet ... dhe elementet qe merr persiper secili prej anetareve te bashkimit”. 2- Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit te shoqerise Nelsa eshte deklaruar ne seksionin e subjekteve mbeshtetes shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k e cila ne dokumentat e tenderit eshte deklaruar si anetare e bashkimit te operatoreve duke mos plotesuar

keshtu kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit përmbledhës të vetedeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e sakta më sipër sic ky formular parashikon. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimit ku ne faqen e dyte rreshti i pare theksohet se ne rast bashkimi te operatoreve, secili anetar i grupit duhet te paraqese Vetedeklarimin e lartpermendurë, si dhe me poshte nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatoresh Ekonomike, do te paraqitet marrrveshje bashkepunimi ku caktohet perfaqesuesi, perqindja e pjesmarrjes ne bashkim”. 3-Ne formularin permbledhes te vetedeklarimit te shoqerise Nelsa sh.p.k eshte paraqitur vetem nje mjet jo frigoriferik ATO me targa AA 978 KU dhe nuk eshte deklaruar mjeti frigoriferik sipas kerkesave te DST ku ofertuesit duhet te disponojne 2 (dy) mjete APV dhe ATP kjo gje bie ne kundershtrim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 3 ku thuhet: kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Pra sic parashikohet ne piken 2.3.7 “Subjekti ofertues duhet te kete ne pronesi ose me qera, nepermjet aktit te pronesise ose kontrates noteriale” 2 mjete APV dhe ATP”. 4- Shoqeria Nelsa nuk ka paraqitur flete analiza ne raport me perqindjen e pjesemarrjes ne bashkimin e operatoreve ekonomike pamvaresisht faktit se ne kontraten e bashkepunimit thuhet se fleteanalizat realizohen nga shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k. Por kjo gje bie ne kundershtrim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 3 ku thuhet: kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Në lidhje me sa më sipër, së pari kërkojmë të sqarojmë se në procedurën e prokurimit objekt ankimi kemi dorëzuar ofertën në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë, bazuar në kontratën e bashkëpunimit me Nr. Repertori 983, Nr. Koleksioni 560, datë 14.05.2025. Bazuar në këtë kontratë lidhur mes palëve ndër të tjera parashikohet pjesëmarrja në realizimin e kontratës ku më konkretisht 90 % e kontratës do të realizohet nga operatori ekonomik El-GJO 2006” Shpk dhe 10% e kontratës do të realizohet nga operatori ekonomik Nelsa Shpk. Gjithashtu në kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë me Nr. Repertori 983, Nr. Koleksioni 560, datë 14.05.2025 përcaktohet shprehimisht se 90 % e kapacitetit ekonomiko-financiar, profesional si dhe teknik do të vihen në dispozicion nga operatori ekonomik “El-GJO 2006” Shpk ndërsa 10 % e kapacitetit ekonomiko-financiar, profesional si dhe teknik do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” shpk. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publikë Në nenin 3 “Parime të

përgjithshme” të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën.

Në nenin 14 “Operatorët ekonomik”, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë. 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të vecantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në cdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjetë një Kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjetë palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht. 4. Operatori ekonomik, anëtar i një

bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së Kontratës, mund të kërkojë që Bashkimi i operatorëve ekonomikë. Të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar. 5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. 6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e vecanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 Për prokurimin publik. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për realizimin me sukses të kontratës harton kriteret në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, dhe gjithashtu dhe në momentin e vlerësimit kryen vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke kryer një interpretim literal dhe sistematik të legjislacionit në fuqi dhe jo duke bërë një interpretim sipërfaqësor, duke patur si objektiv kryesor krijimin e bindjes për kapacitetet që zotërojnë operatorët ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës si dhe duke maksimizuar efiçencën dhe konkurrencën e procedurës së prokurimit si dhe mirëpërdorimin e fondeve publike. Në një interpretim sistematik dhe literal të kuadrit ligjor në fuqi konsatojmë se në marrëveshjen e bashkëpunimit operatorët ekonomikë përcaktojnë zërat dhe elementët konkretë të bashkëpunimit në përputhje ligjin “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij duke përcaktuar konkretisht jo vetëm mjetet, stafin si dhe volumin dhe natyrën e angazhimit të secilit prej anëtarëve të bashkimit në realizimin me sukses të kontratës por gjithashtu kanë përcaktuar saktësisht edhe përmbushjen e secilit prej kapaciteteve ekonomiko-financiar, teknike, profesionale nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret, pasi morëm në shqyrtim arsyet e skualifikimit të BOE konstatojmë se jo vetëm që kemi të bëjmë me arsye tërësisht të paargumentuara dhe të pabazuara në ligj dhe në fakt por kemi të bëjmë me arsye artificiale të krijuara me qëllimin e vetëm iskualifikimit të ofertës sonë pasi:

Së pari, në lidhje me skualifikimin me pretendimin se: “1- Kontrata e bashkëpunimit mes Paleve nr. 983 rep date 14.05.2025 nuk është bere ne respektim te VKM Nr. 285, datë

19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 1 ku thuhet: Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve, pasi në kontratën e bashkëpunimit është bere vetem ndarja ne perqindje 10% me 90% ndermjet subjekteve por nuk jane percaktuar elementet konkrete pasi nuk eshte percaktuar se cilet artikuj konkretisht merr persiper te furnizoje njera pale dhe pala tjeter pjese e akt/marreveshjes. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimi ku ne faqen e dyte parashikohet nese oferta paraqitet nga nje bashkim operatoresh ekonomike, do te paraqitet marrreveshje bashkëpunimi ku caktohet ... dhe elementet qe merr persiper secili prej anetareve te bashkimit”.

Në rastin konkret kërkojmë të ritheksojmë se bazuar në kontratën e bashkëpunimit me Nr. repertori 983, Nr. koleksioni 560, datë 14.05.2025 oferta e shoqërisë është paraqitur si bashkim operatorësh midis operatorëve ekonomikë “El-GJO 2006” Shpk dhe “Nelsa” Shpk. Bazuar në këtë kontratë të lidhur mes palëve ndër të tjera parashikohet se 90 % e kontratës do të realizohet nga operatori ekonomik “El-GJO 2006” Shpk dhe 10% e kontratës do të realizohet nga operatori ekonomik “Nelsa” Shpk. Gjithashtu në kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomik me Nr. Repertori: 983, Nr. Koleksioni 560, datë 14.05.2025 përcaktohet shprehimisht se 90 % e kapacitetit ekonomiko-financiar, profesional si dhe teknik do të vihen në dispozicion nga nga operatori ekonomik “El-GJO 2006” Shpk ndërsa 10 % e kapacitetit ekonomiko-financiar, profesional si dhe teknik do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” SHPK. Në lidhje me sa më sipër, së pari kërkojmë të sqarojmë autoritetin kontraktor se në kontratën e bashkëpunimit janë paraqitur në mënyrë të detajuar ndarjet në përqindje të secilit prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë përsa i përket pjesëmarrjes dhe furnizimit në këtë BOE ku më konkretisht është parashikuar se shoqëria “Nelsa” Shpk, do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë, pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurimi, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi; shoqëria “El-GJO 2006” Shpk do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi, si edhe vë në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësve të nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi, duke bërë një ndarje në përqindje të pjesëmarrjes në furnizim për secilin prej anëtarëve të BOE. Akoma më tej, për të bërë një ndarje akoma më të detajuar jo vetëm të pjesëmarrjes në furnizim por edhe të përmbushjes së kapaciteteve ekonomiko-financiare, profesionale dhe teknike në kontratën e bashkëpunimit është parashikuar se: “shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë pjesëmarrje, do të kontribuojnë edhe me kapacitetin teknik, financiar të cilat do të vendosen në dispozicion për të përmbushur plotësisht objektin e kontratës. Bazuar në këtë kontratë lidhur mes palëve 10 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria inelsaë shpk ndërsa 90 % e kapacitetit teknik, financiar do te vihen ne dispozicion nga shoqëria “El-GJO 2006” Shpk, duke specifikuar në këtë mënyrë përqindjen e secilit prej anëtarëve të bashkimit në përmbushjen e këtyre kapaciteteve. Në lidhje me sa më sipër, konstatojmë se pretendimi i autoritetit kontraktor është i pabazuar në ligj dhe në fakt dhe nuk qëndron pasi vlerësojmë se në kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë me Nr.

repertori 983, Nr. koleksioni 560, datë 14.05.2025, është parashikuar në mënyrë të qartë ndarja në përqindje për përmbushjen e kapaciteve ekonomiko-financiare, profesionale dhe teknike por gjithashtu është parashikuar shprehimisht edhe pjesëmarrja në ekzekutimin e kontratës dhe në furnizim për secilin prej anëtarëve të BOE.

Së dyti, vlerësojmë se autoriteti kontraktor në shqyrtimin e ofertave dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore por duhet të vlerësojë duke u bazuar në një interpretim literal dhe sistematik të legjislacionit në fuqi. Në një interpretim literal dhe sistematik ligji nuk përcakton domosdoshmërisht ndarjen sipas artikujve pjesë të preventivit, por parashikon vetëm ndarjen në përqindje përsa i përket pjesëmarrjes në furnizim dhe në rastin konkret kjo ndarje është parashikuar shprehimisht në kontratën e bashkëpunimit. Kërkojmë të na sqarohet nga autoriteti kontraktor, nisur nga arsyeja e skualifikimit në rastin konkret si do realizohet ndarja në përqindje. Sipas zërave të produkteve, sipas sasive apo sipas vlerave të ofertuara. Vlerësojmë se ndarja sipas zërave të preventivit realizohet në rastin e punëve apo shërbimeve që kanë procese të ndryshme për realizimin e të cilave kërkohet staf i specializuar, mjete të ndryshme dhe/ose licenca të ndryshme dhe në këtë rast ndahet përqindja në varësi të punëve apo shërbimeve që i përket licencës që disponon secili nga operatorët ekonomikë dhe mjeteve ose stafit të specializuar që ka secili prej OE. Ndërsa në rastin konkret vlerësojmë se nuk mund dhe nuk është e nevojshme të realizohet ndarja sipas preventivit, por gjykojmë se për të krijuar një panoramë më të qartë për pjesëmarrjen e BOE dhe për tu garantuar për disponimin e kapaciteteve për realizimin me sukses të kontratës për autoritetin kontraktor është mëse e mjaftueshme ndarja në përqindje përsa i përket pjesëmarrjes në furnizim si dhe ndarja në përqindje për përmbushjen e kapaciteve ekonomiko-financiare, profesionale dhe teknike.

Në lidhje me skualifikimin e ofertës sonë me pretendimin se: 2- Ne formularin përmbledhës të vetdeklarimit të shoqërisë Nelsa është deklaruar në seksionin e subjekteve mbështetës shoqëria El-Gjo 2006 sh.p.k e cila në dokumentat e tenderit është deklaruar si anëtare e bashkimit të operatoreve duke mos plotësuar kështu kriterin e vecantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit përmbledhës të vetdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e sakta më sipër si ky formular parashikon. Ky rregull paraqitet qartë në kriteret e përgjithshme të pranimit ku në faqen e dytë rreshti i parë theksohet se në rast bashkimi të operatoreve, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë vetedeklarimin e lartpërmendurë, si dhe me poshte nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet marrëveshje bashkëpunimi ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, vlerësojmë se është tërësisht e pabazuar në ligj dhe në fakt dhe si e tillë nuk qëndron.

Së pari, kërkojmë të sqarojmë se në plotësimin e formularit përmbledhës të vetedeklarimit nga operatori ekonomik “Nelsa” Shpk, në pjesën e I, pika B “Deklaratë për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilave do të mbështetet operatori ekonomik, është specifikuar shprehimisht se “Bazuar në marrëveshjen e BOE operatori ekonomik “El-GJO 2006” Shpk do të përmbushë 90% të kapacitetit ekonomik-financiar dhe teknikë, pra është shkruar shprehimisht që kemi të bëjmë me një marrëveshje bashkimi operatorësh ekonomik duke mos

lënë vënd për konfuzion apo paqartësi për autoritetin kontraktor. Në këtë rast forma e mbështetjes në kapacitetet e operatorit ekonomik “El-GJO 2006” Shpk është nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë, vërtetuar kjo edhe me kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë me Nr. repertori: 983, Nr. Koleksioni 560, datë 14.05.2025, kontratë e cila është dorëzuar në SPE në momentin e ofertimit duke krijuar në këtë mënyrë një panoramë të qartë për autoritetin kontraktor se forma e mbështetjes në kapacitetet e operatorit “El-GJO 2006” Shpk është nëpërmjet BOE. Pra, në rastin konkret vlerësojmë se autoriteti kontraktor ka dështuar në argumentimin e kësaj arsye skualifikimi por mbi të gjitha është një arsye skualifikimi tërësisht e pabazuar në ligj dhe në fakt dhe si e tillë nuk qëndron.

Së dyti, kërkojmë të sqarojmë se përsa i përket formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nuk ka një formular tipë të plotësuar si shembull nga institucionet kompetente dhe për aq kohë sa nuk ka një model të përcaktuar nuk mund të skualifikohet një operator ekonomik për dicka të paparashikuar. Në rastin konkret pavarësisht faktit se formulari përmbledhës i vetëdeklarimit nga operatori ekonomik është plotësuar në mënyrë të saktë dhe nuk krijon paqartësi tek autoriteti kontraktor, edhe nëse operatori ekonomik pjesëmarrës do të kishte kryer një lapsus të thjeshtë formal në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë një operator ekonomik për arsye të cilat nuk janë thelbësore dhe nuk ndikojnë në përmbushjen e kërkesave për kualifikim dhe të ofertës ekonomike, duke krijuar një dëm ekonomik për buxhetin e “Bashkisë Shkodër” prej 3,600,000 lekë. Vlerësojmë se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore por duhet të vlerësojë ofertat duke bërë një interpretim sistematik dhe literal të kuadrit ligjor në fuqi, duke mbajtur në konsideratë parimet dhe qëllimet e legjislacionit në fuqi por në të njëjtën kohë duhet të bëjë një analizë më të detajuar duke marrë në konsideratë dokuementacionin e dorëzuar në tërësi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Në lidhje me sa më sipër, autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e legjislacionit në fuqi si dhe në kundërshtim me Parimin e Formalitetit të arsyeshëm (Substantial Compliance). Parimi i formalitetit të arsyeshëm (ose i substantial compliance) është një parim i pranuar gjerësisht në jurisprudencën shqiptare dhe ndërkombëtare të prokurimit publik. Ky parim nënkupton që një dokument apo element formal nuk duhet të cojë në skualifikim nëse përmbajtja thelbësore e kërkesës është përmbushur, dhe nuk preken kriteret thelbësore të vlerësimit, ndershmëria e garës ose realizimi i kontratës. Bazuar në këtë parim mungesat formale apo pasaktësitë që nuk ndikojnë në vlerësimin e ofertës dhe nuk pengojnë zbatimin e kontratës, nuk përbëjnë bazë të ligjshme për skualifikim. Në rastin konkret jo vetëm që nuk do të kishim të bënim me një kriter thelbësor të vlerësimit por mbi të gjitha kemi të bëjmë me një pikë që autoriteti kontraktor kishte mundësi të krijonte qartësi pasi BOE ka dorëzuar në SPE edhe kontratën e bashkëpunimit ku përcaktohet qartësisht jo vetëm forma e bashkëpunimit por bëhet edhe ndarja në përqindje dhe çfarë merr përsipër të realizojë secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu autoriteti kontraktor kishte mundësinë të qartësonte mënyrën e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë duke marrë në shqyrtim dokuementacionin e dorëzuar në tërësi nga BOE pasi të gjitha dokumentat si më poshtë vijon të ofertës konfirmojnë natyrën reale të marrëdhënies:

- marrëveshja e bashkëpunimit mes dy operatorëve;*
- formulari i ofertës së përbashkët;*
- prokurë e posadmeë i përfaqësuesit të autorizuar;*

- ndarja e përqindjeve të pjesëmarrjes.

Akoma më tej, edhe nëse autoriteti kontraktor do të kishte përsëri paqartësi, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, në rast paqartësie autoriteti kontraktor duhet të shfrytëzonte cdo mundësi që i jep kuadri ligjor në fuqi për tu qartësuar. Në nenin 26, pika 7 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në cdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose të kërkoj. Operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Në lidhje me sa më sipër, konstatojmë se ligjvënësi i jep mundësinë autoritetit kontraktor që në funksion të efikasitetit të procedurës së prokurimit dhe të mirëpërdorimit të fondeve publike, në rast se ka nevojë për dokumenta provuese apo për sqarime mund t’i kërkojë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës sqarimet e nevojshme dhe jo që të skualifikojë operatorët ekonomikë për arsye tërësisht të pabazuara në ligj dhe në fakt. Vlerësojmë se pavarësisht të gjitha mundësive që legjislacioni i lejon dhe pavarësisht se dokumentacioni i dorëzuar në SPE është i saktë, i qartë dhe nuk krijon vend për konfuzion, autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me qëllimin dhe parimet e legjislacionit në fuqi, dhe në mënyrë tërësisht të paargumentuar dhe të pambështetur në ligj dhe në fakt ka skualifikuar ofertën tonë.

Në lidhje me skualifikimin e ofertës sonë me pretendimin se: “3-Ne formularin përmbledhes të vetdeklarimit të shoqërisë Nelsa sh.p.k është paraqitur vetëm një mjet jo frigoriferik ATO me targa AA 978 KU dhe nuk është deklaruar mjeti frigoriferik sipas kërkesave të DST ku ofertuesit duhet të disponojnë 2 (dy) mjete APV dhe ATP kjo gjë bie në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 3 ku thuhet: kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Pra sic parashikohet në pikën 2.3.7 subjekti ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera, nepermjet aktit të pronësisë ose kontrates noteriale 2 mjete APV dhe ATP, vlerësojmë se është e pambështetur në ligj dhe në fakt dhe si e tillë nuk qëndron.

Në shtojcën 8 kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik i dokumentave të tenderit është parashikuar se: “2.3.7 Subjekti ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontrates noteriale të qerave, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, 2 (dy) mjete transporti të pershtatshëm për transportin e produkteve ushqimore, të shoqëruar me leje qarkullimi, police sigurimi, akt kolaudimi, foton perkatese si dhe lejen higjieno-sanitare, ku njëri prej tyre të jetë ATP (frigorifer) ndërsa tjetri mjet ATV. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor. Në nenin 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët

ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, sic është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Në nenin 40 pika 5 gërma “a” e Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës ; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit

ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që tili shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëkudo në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tili përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe në fazën e vlerësimit të tyre. Pasi morëm në shqyrtim kërkesën e mësipërme konstatojmë se për përmbushjen e kontratës autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponimin e 2 (dy) mjeteve transporti, 1 (një) mjet ATV dhe 1 (një) mjet ATP. Në rastin konkret, për përmbushjen e kërkesës së mësipërme operatori ekonomik “El-GJO 2006” Shpk i cili bazuar në marrëveshjen e BOE do të përmbushë 90% të kapaciteteve teknike ka deklaruar disponimin e 2 mjeteve transporti (një mjet ATP dhe një mjet ATV), pra duke përmbushur 100% kërkesën e mësipërme edhe pse duhet të përmbushë minimalisht 90 % të saj, ndërsa operatori ekonomik “Nelsa” Shpk i cili bazuar në marrëveshjen e BOE do të përmbushë 10% të kapaciteteve teknike ka deklaruar disponimin e një mjeti transporti ATP duke përmbushur në këtë mënyrë 50 % të kërkesës së mësipërme edhe pse duhet të përmbushë minimalisht 10% të saj. Kërkojmë të sqarojmë autoritetin kontraktor se në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë kapacitetet ekonomike-financiare, profesionale dhe teknike përmbushen në mënyrë kumulative nga bashkimi i operatorëve ekonomikë duke u bazuar në përqindjen që ka secili prej anëtarëve të BOE. Në rastin konkret, kërkojmë të sqarojmë se BOE duhet të disponojë 2 mjete transporti (një mjet ATP dhe një mjet ATV) në total, pra së bashku dhe jo nga 2 mjete secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Nëse secili prej anëtarëve të BOE duhet të dorëzonte nga 2 mjete cili do të ishte qëllimi i realizimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Sqarojmë se ligjvënësi jep mundësinë e krijimit të BOE pikërisht për të dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që së bashku të përmbushin kërkesat për kualifikim edhe në rastet kur të vetëm nuk mundën t’i përmbushin ato. Akoma më tej, fakti që operatori ekonomik do të vejë në dispozicion për transportin e produkteve objekt prokurimi vetëm një mjet është parashikuar shprehimisht edhe në kontratën e bashkëpunimit ku më konkretisht është përcaktuar shoqëria “Nelsa” Shpk, do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë, pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurimi, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Në lidhje me sa më sipër,

vlerësojmë se arsyeja e mësipërme e skualifikimit është tërësisht e pabazuar në ligj dhe në fakt dhe si e tillë nuk qëndron.

Në lidhje me skualifikimin e ofertës sonë me pretendimin se: 4- Shoqeria Nelsa nuk ka paraqitur flete analiza ne raport me përqindjen e pjesëmarrjes ne bashkimin e operatoreve ekonomike pamvaresisht faktit se ne kontraten e bashkepunimit thuhet se flete analizat realizohen nga shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k. Por kjo gje bie ne kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 3 ku thuhet: kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, vlerësojmë se është e pambështetur në ligj dhe në fakt dhe si e tillë nuk qëndron. Në rastin konkret, gjykojmë se raport analizat janë dokumenta të cilat tregojnë kapacitetet e operatorëve ekonomikë por cilësinë e produkteve objekt prokurimi dhe për këtë arsye duke mos qenë dokumenta të cilat pasqyrojnë kapacitetet e operatorëve ekonomikë vlerësojmë se mund të dorëzohen edhe vetëm nga njëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe ky kriter të konsiderohet i përmbushur. Nëse ndjekim linjën e argumentimit të autoritetit kontraktor po në rastin kur njërin produkt do e dorezojnë të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë atëherë duhet te kryhen 2 raport analiza. Apo ne rastin kur kerkohen mostra produktesh duhet te dorezojne mostra secili nga anetaret e bashkimit te operatoreve. Në gjykimin tonë e rëndësishme në këtë rast është të vërtetohet përmbushja e specifikimeve teknike të parashikuara në DST pavarësisht faktit se cili prej anëtarëve të BOE i dorëzon ato. Në rastin konkret kërkojmë të theksojmë se raport analizat janë dorëzuar nga operatori ekonomik që zoteron përqindjen më të madhe sipas marrëveshjes së bashkimit të operatorëve ekonomikë (90 % të pjesëmarrjes) duke e përmbushur këtë kërkesë. Vlerësojmë se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është të vërtetohet që produktet objekt prokurimi përmbushin kërkesat e cilësisë dhe jo fakti nëse raport analizat janë dorëzuar në laborator për analizim nga njëri prej anëtarëve apo nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu edhe në marrëveshjen e bashkimit të operatorëve ekonomikë është parashikuar shprehimisht që raport analizat për produket objekt prokurimi do të realizohen nga operatori ekonomik “El GJO 2006” i cili shfaqet në cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit dhe gjithashtu si anëtari me pjesëmarrjen kryesore në këtë bashkim.

Sa më sipër vlerësojmë se arsyeja e mësipërme e skualifikimit është tërësisht e pabazuar në ligj dhe në fakt dhe për këtë arsye nuk qëndron. Gjithashtu theksojmë se skualifikimi në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në fakte i ofertës sonë i shkakton një dëm ekonomik prej 3,600,000 lekë buxhetit të “Bashkisë Shkodër” pasi është oferta me cmimin më të ulët që përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentat standarte të tenderit.

Sa më sipër kërkojmë:

- 1. Pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi*
- 2. Kualifikimin e ofertës së BOE El-GJO 2006 Shpk dhe Nelsa Shpk*

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin,

adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1504/1 prot., datë 12.06.2025, me arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1504/2025 prot, datë 11.06.2025.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1504/2 prot., datë 01.07.2025, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhenie informacion KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik El Gjo 2006 SHPK”, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.9. Nëpërmjet shërbimit postar autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën nr. 13486/1 prot, datë 04.07.2025 me objekt “Informacion” protokolluar me tonën me nr. 1504/3 prot, datë 07.07.2025, si dhe nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike ka dërguar shkresën nr. 7218/12 prot, datë 16.06.2025 me objekt “Kthim Përgjigje”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1504/4 prot, datë 07.07.2025 nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës të operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si vijon:

Ne lidhje me ankesën tuaj dërguar në mënyrë elektronike me Numri i protokollit: 1504/2025 Data e protokollit: 2025-06-11 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe në adresën e Bashkise Shkoder në e-Albania drejtuar autoritetit kontraktor Bashkia Shkoder ku kundërshtoni arsyet e skualifikimit të ofertes tuaj nga KVO në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje e artikujve ushqimorë” ju informojmë si më poshtë: Me marrjen e ankesës procedura e prokurimit është pezulluar dhe shqyrtimi i saj i është ngarkuar Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.

Pasi u njoha me relacionin dhe vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës ju parashtrojmë sqarimet si më poshtë:

1-Ju jeni skualifikuar nga KVO me kete pretendim:

1-Kontrata e bashkepunimit mes paleve nr.983 rep date 14.05.2025 nuk është bere në respektim të VKM Nr. 285, date 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 1 ku thuhet: Në oferte duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkepunimi të hartuar ndërmjet paleve, pasi në kontratën e bashkepunimit është bere vetëm ndarja në përqindje 10% me 90% ndërmjet subjekteve por nuk janë përcaktuar elementet konkrete pasi nuk është përcaktuar se cilët artikuj konkretisht merr persiper të furnizojë njera pale dhe pala tjetër pjesë e akt/marrëveshjes. Ky rregull paraqitet qartë në kriteret e përgjithshme të pranimit ku në faqen e dytë parashikohet “Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomike, do të paraqitet marrëveshje bashkepunimi ku caktohet.....dhe elementet që merr persiper secili prej anëtareve të

bashkimit”.

Pretendimet tuaja per kete pike te skualifikimit te bere nga KVO nder te tjera jane se ne kontraten e bashkepunimit nuk mund dhe nuk eshte e nevojshme te realizohet ndarja sipas zerave te preventivit por eshte mese e mjaftueshme ndarja ne perqindje persa i perket pjesemarrjes ne furnizim.

Ne nenin 14, “Operatoret ekonomike”, pika 2 e Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Grupe operatoresh ekonomike mund te dorezojne oferta ose te peragiten si nje kandidat i vetem sipas parashikimeve ne rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kerkoje nje forme te vecante ligjore bashkimit te shoqerive, per qellim te dorezimit te ofertes ose kerkeses per pjesemarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kerkojne grupeve te operatorëve ekonomike qe te marrin nje forme ligjore specifike, pasi te jene shpallur fitues, nese vleresohet e nevojshme per realizimin e kontrates. Ne çdo rast, ky kusht duhet t'u behet i ditur operatoreve ekonomike ne dokumentet e tenderit per ekzekutimin e kenaqshem te kontrates. Rregullat per menyren e plotesimit te kriterave nga grupet e operatoreve ekonomike ne një procedure prokurimi percaktohen ne rregullat e prokurimit publik. Ndersa ne nenin 88 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i dryshuar parashikohet shprehimisht se: “1.Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operatoresh ekonomike, sipas percaktimit te pikave 2 dhe 3, te nenit 14, te LPP-se, ku njëri prej te cileve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe, ne rast perzgjedhjeje, edhe gjate zbatimit te kontrates. Ne oferte duhet te percaktohet pjesa e sherbimit, punes ose furnizimit, ge do te kryeje secili nga anëtarët e ketij bashkimi nepermjet nje kontrate bashkëpunimi te hartuar ndermjet palëve. Anëtarët e bashkimit te operatorëve ekonomike caktojne ne kontraten e bashkëpunimit ndermjet tyre perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo kontrate bashkepunimi duhet te dergohet se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi. Perfaqesuesi duhet te beje edhe sigurimin e ofertes, duke specifikuar pjesemarrjen ne bashkimin e operatorive ekonomike. Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushë kerkesat e parashikuara ne nenin 76, te LPP-se, dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat per kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyren e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarreveshje. Kur oferta paraqitet nga nje bashkim operatoresh, kushti i percaktuar ne shkronjen “a”, te pikes 5, te nenit 39, te ketyre regullave, plotesohet nga anetari, i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anëtarët e tjere te bashkimit do te paraqesin kontrata te ngjashme, ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Ne rastin kur operatoret ekonomike, anëtare te nje bashkimi, kane te njejten perqindje pjesemarrjeje ne bashkim, vendosin me marreveshje ne kontraten e bashkepunimit se cila prej tyre do te permbushë kete kusht. Operatori ekonomik, anetar i nje bashkimi, nuk mund te paraqese njekohesisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatoreve ekonomike nuk ndryshon pas dorezimit te ofertes, ne të kundert oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes se kontrates, mund te kerkoje qe bashkimi i operatoreve ekonomike te krijohet zyrtarisht me nje marreveshje te noterizuar. Ne rast se bashkimi i operatoreve ekonomike shpallet fitues, kontrata duhet te nënshkruhet nga secili prej anetareve te ketij

bashkimi. Ne rast falimentimi te nje prej anetareve te bashkimit te operatoreve ekonomike ose ne rrethana te tjera, qe nderpresin veprimtarine e tij gjate zbatimit te kontrates, autoriteti/enti kontraktor mund te vazhdoje kontraten me operatorin/ët e tjere ekonomike, anëtare te bashkimit, me kusht qe ai te zoteroje kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike per te zbatuar kontratën. Perndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.SH.A. konstaton se ne marreveshjen e bashkepunimit por edhe ne oferte/preventivin e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomike ankimues nuk jane parashikuar ne menyre te detajuar elementet konkrete te furnizimit qe do te kryeje secili prej anëtareve te bashkimit te operatoreve ekonomike ankimues. Referuar nenit 88 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se ne oferte duhet te percaktohet pjesa e sherbimit, punes ose furnizimit, qe do te kryeje secili nga anëtaaret e ketij bashkimi. Sa me sipër, K.SH.A. konstaton se marreveshja e bashkepunimit dhe oferta e dorezuar nga bashkimi i operatoreve ekonomike nuk permbush nje prej kushteve kryesore te parashikuar nga VKM Nr.285/2021. K.SH.A. sqaron se ndarja e zerave konkrete eshte nje kerkese e parashikuar ne aktin normativ si me sipercituar dhe eshte nje faktor i rendesishem mbi te cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e permbushjes se secilit kriter te percaktuar ne dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithnje ne perputhje me perqindjen e marre persiper ne kontraten e bashkepunimit. Ne rastin konkret eshte percaktuar vetem perqindia e pjesmartjes ne bashkepunim per secilin nga anëtaaret e bashkimit por ne oferte/preventivin e paraqitur dhe as ne marreveshjen e bashkepunimit nuk rezulton ndarja e zervave dhe elementeve konkrete te punimeve qe do te realizoje secili prej tyre. K.SH.A. gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, per vertetimin e krijimit te bashkimit dhe konkretisht kontrata e bashkepunimit ne te cilen nuk është bere ndarja konkrete e zerave te furnizimeve objekt prokurimi, nuk eshte hartuar ne perputhje me legjislacionin per prokurimin publik, duke bere te pamundur verifikimin e plotesimit te dokumentacionit te paraqitur nga secili anetar i ketij bashkimi ne perputhje me perqindjen e marre persiper. Pretendimi i ankimuesit se ne kontraten e bashkepunimit nuk mund dhe nuk eshte e nevojshme te realizohet ndarja sipas zerave te preventivit por eshte mese e mjaftueshme ndarja ne perqindje persa i perket pjesemarrjes ne furnizim K.SH.A. e gjen te pabazuar pasi forma e pjesmarjes ne rastin e bashkimit te operatorive ekonomike ne nje procedure prokuruese eshte e percaktuar shprehimisht ne ligj dhe ne aktet nenligjore ne zbatim te saj dhe nuk le vend per konfuzion. Ne kete kuptim K.SH.A gjykon se BOE ankimues ka pasur detyrimin ligjor te paraqese kontraten e bashkepunimit, oferte preventivin ne perputhje me percaktimet ligjore duke percaktuar ne to pjesen e furnizimit/mallit qe do te realizoje secili prej tyre ne perputhje me perqindjen e percaktuar ne kontrate. K.SH.A gjykon se vleresimi i ofertave te operatoreve ekonomike behet mbi bazën e dokumentacionit te ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike dhe jo ne baze te interpretimeve qe behen pas faze se dorezimit te ofertave per te kuptuar se cfare kane dashur palet te shprehin ne kontrate. Bazuar ne sa me sipër, K.SH.A sqaron se ne nje procedure prokurimi subjekti i pare i interesuar eshte operatori ekonomik, i cili e pergatit oferten ekonomike ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi dhe nga ana tjeter eshte autoriteti kontraktor, i cili perzgjedh operatorin

ekonomik qe ploteson te gjitha kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit dhe qe ka pergatitur oferten ne perputhje me LPP.

Neni. 77 “Kerkesat per kualifikim”, te ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne: a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftesine teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Ne lidhje me kete pike, arsyet e skualifikimit te bera nga KVO qendrojne dhe jane te mbeshtetura ne LPP dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

2-Ju jeni skualifikuar nga KVO me kete pretendim:

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit te shoqerise Nelsa eshte deklaruar ne seksionin e subjekteve mbeshtetes shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k e cila ne dokumentat e tenderit eshte deklaruar si anetare e bashkimit te operatorëve duke mos plotesuar keshtu kriterin e vecante të kualifikimit, lidhur me plotesimin e sakte te shtojces 9, sipas kerkesave te Formularit Permbledhes te Vetëdeklarimit, pjese e dokumenteve te tenderit, duke mos dhenë te dhenat e sakta me siper siç ky formular parashikon. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimit ku ne faqen e dyte rreshti i pare theksohet se “Ne rast bashkimi te operatorëve, secili anetar i grupit duhet te paraqese vetedeklarimin e lartpermendur”, si dhe me poshte “Nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatorësh Ekonomike, do te paraqitet marrreveshje bashkepunimi ku caktohet perfaqesuesi, perqindja e pjesmarrjes ne bashkim. Pretendimet tuaja per kete pike te skualifikimit te berë nga KVO nder te tjera eshte se me formularin permbledhes te vetdeklarimit te shoqerise Nelsa sh.p.k eshte shprehur qe kemi te bejme me nje marrreveshje bashkepunimi dhe fakti qe eshte plotesuar edhe tek seksioni mund te konsidrohesh thjeshte nje lapsus. Ne nenin 14, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se: “APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde te tenderit qe do te perdoren gjate procedurave te prokurimit, per çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, te LPP-se, dhe çdo tip kontrate. Ne DST e publikuara nga Autoriteti Kontraktor, Shtojca 9, Formulari Permbledhes i Vetdeklarimit, citohet si me poshte:

Cdo vetdeklarim i pavertete/pasakte nga ana e operatorëve ekonomike jo vetem qe perbën shkak per skualifikimin nga procedura konkrete, por perbën shkak dhe per perjashtimin e tyre nga e dreja per te fituar kontrata publike deri ne 3 vjet, sipas parashikimeve te ligjit per prokurimin publik.

- Operatores ekonomike qe ofertojne ne procedurat e prokurimit te vetdeklarojne ne çdo rast informacionin e sakte qe i korrespondon gjendjes se tyre faktike.

Bazuar sa me lart eshte pergjegjesi dhe detyrim ligjor i ofertuesve qe te plotesonte dokumentat e tenderit ne perputhje me DST e miratuara e te publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe informacioni i paraqitur ne te duhet te jete i sakte. Ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit, ne seksionin I, udhezime per Operatores Ekonomike, ne piken 2 shkronja b percaktohet se “Operatori Ekonomik duhet te konsultohet me te gjitha udhezimet, formularet, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhenia nga operatori ekonomik e te gjithë informacionit ose dokumentacionit te kerkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ne Dokumentet e Tenderit, do te coje ne refuzimin e Ofertes”. Gjithashtu ne piken 4 te ketij seksioni percaktohet se: Operatori Ekonomik eshte pergjegjes per te gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjese e Ofertes. Ne rast te verifikimit te permbajtjes se dokumentacionit te paraqitur, ose te Vetedeklarimeve, kur permbajtja e tyre nuk rezulton te jete e vertete, Operatori Ekonomik eshte ne kushtet e parashikuara ne nenin 78, pika 1, germa (a) te Ligjit per Prokurimin Publik (LPP). Formulimi i shtojcave dhe deklarave te miratuara nga ligjvendi ne DST-ne e kesaj procedure eshte bere per faktin se te gjithë operatores ekonomike te deklarojne me pergjegjesi te plote sipas formatit te miratuar, duke mos lene asnje mundesi shmangie nga deklarimet apo pergjegjesite që marrin operatores me ane te ketyre deklarimeve. Gjithashtu, vlen te theksojme se, dokumentat standarte te tenderit, jane dokumenta, qe autoriteti kontraktor ua ve ne dispozicion kandidateve dhe ofertuesve te mundshem per pergatitjen e ofertave. Ne hartimin e ketyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet te perdore dokumentat standarde te tenderit. Rrjedhimisht, qe nga data kur ka hyre ne fuqi vendimi per miratimin e ndryshimeve te dokumentave te tenderit, te gjitha procedurat e prokurimit do te shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit te ri te dokumentave standarde te tenderit, te miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, te cilat jane te detyrueshme per tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatores ekonomike te cilet marrin pjese ne nje procedure prokurimi publik.

Ne lidhje me kete pike, arsyet e skualifikimit te bera nga KVO qendrojne dhe jane te mbeshtetura ne LPP dhe VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

3-Ju jeni skualifikuar nga KVO me kete pretendim:

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit te shoqerise Nelsa sh.p.k eshte paraqitur vetem nje mjet jo frigoriferik ATP me targa AA 978 KU dhe nuk eshte deklaruar mjeti frigoriferik sipas kerkesave te DST ku ofertuesit duhet te disponone 2 (dy) mjete APV dhe ATP kjo gje bie ne kundërshtim me VKM Nr. 285, date 19.5.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 3 ku thuhet: Kërkesat per kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyren e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarreveshje. Pra sic parashikohet ne piken 2.3.7 “Subjekti ofertues duhet te kete ne pronesi ose me qera, nepermjet aktit te pronesise ose kontrates

noteriale...2 mjete APV dhe ATP ...”. Pretendimet tuaja per kete pike te skualifikimit te bere nga KVO nder te jera jane se ju si bashkim operatoresh ekonomike keni deklaruar gjithsej 3(tre) mjete transporti nga 2 (dy) te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. Sic eshte cituar edhe ne piken 1, K.SH.A. sqaron se ndarja e zerave konkrete eshte nje kerkese e parashikuar ne aktin normativ si me sipercituar dhe eshte nje faktor i rëndesishem mbi te cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e permbushjes se secilit kriter te percaktuar ne dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paragitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithje ne perputhje me pergindjen e marr persiper ne kontraten e bashkepunimit. Ne rastin konkret eshte percaktuar vetem perqindja e pjesmarjes ne bashkepunim per secilin nga anëtarët e bashkimit por ne oferte/preventivin e paraqitur dhe as ne marreveshjen e bashkepunimit nuk rezulton darja e zervave dhe elementeve konkrete te punimeve qe do te realizoje secili prej tyre.

Ne Rekomandimin Nr. 10181 prot., date 19.11.2018 dhe nr. 8514 prot., date 19.11.2018 midis Agjencise së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit me objekt “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore” ne paragrafin III “Hartimi i Kriterëve te Veçanta per Kualifikim”, pika “e” percakton: “Ne hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim, autoriteti kontraktor duhet te mbaje ne konsiderate qe: Operatori te kete ne pronesi ose ne perdorim, automjet te pershtatshem ATV (frigorifer) per transportimin e mallrave, automjet te pershtatshem ATP (jo frigorifer) per transportimin e mallrave, ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara dhe qe plotesone kushtet higjeno sanitare. Ne rastin konkret shoqeria Nelsa sh.p.k ka paraqitur vetem je mjet jo frigoriferik ATP me targa AA 978 KU por ne akmarreveshjen e bashkepunimit nuk jane percaktuar produktet konkrete qe merr persiper te furnizojë kjo shoqeri nese jane me origjine shtazore dhe nevojitet mjet frigoriferik apo jo shtazore ku nevojitet vetem ne mjet jo frigoriferik ATP.

K.SH.A gjykon se vleresimi i ofertave te operatoreve ekonomike behet mbi bazën e dokumentacionit te ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike dhe ne rastin konkret dokumentacioni i paraqitur nga BO eshte i manget pasi referuar aktmarreveshjes se bashkepunimit ne kushtet kur nuk jane percaktuar elementet konkrete qe ka marre persiper te furnizojë shoqeria Nelsa sh.p.k duhej te kishte paraqitur edhe nje mjet mjet frigoriferik APV. Ne rastin konkret lind pyetja po sikur shoqeria Nelsa sh.p.k. do furnizonte artikuj me origjine shtazore sipas pjeses prej 10% qe ka marre persiper te realizojë sipas akmarreveshjes dhe qe nuk eshte percaktuar me elemente konkrete, cfare automjeti do perdorte per transportin e ketyre produkteve?.

Ne lidhje me kete pike, arsyet e skualifikimit te bera nga KVO qendrojne dhe jane te mbeshtetura ne LPP dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

4-Ju jeni skualifikuar nga KVO me kete pretendim:

Shoqeria Nelsa nuk ka paraqitur flete analiza ne raport me perqindjen e pjesemarries ne

bashkimi e operatoreve ekonomike pamvaresisht faktit se ne kontraten e bashkepunimit thuhet se fleteanalizat realizohen nga shoqeria EL-Gjo 2006 sh.p.k. por kjo qe bie ne kundërshtim me VKM Nr. 285, date 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, neni 88 "Bashkimi i operatoreve ekonomike", pika 3 ku thuhet: Kërkesat per kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyren e pjesemarrjes ne pune, shërbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarreveshje. Pretendimet tuaja per kete pike te skualifikimit te bere nga KVO jane se fleteanalizat jane dokumente qe nuk tregone kapacitetet e operatoreve ekonomike por cilesine e produkteve objekt prokurimi prandaj vleresojme se ky kriter mund te plotesohet edhe vetem nga njeri anetar i bashkimit te operatoreve ekonomik. Ne nenin 88 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: "1.Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operatorësh ekonomike, sipas percaktimit te pikave 2 dhe 3, te nenit 14, te LPP-se, ku njeri prej te cileve i perfaqeson te tjerët gjate procedures dhe, ne rast perzgjedhjeje, edhe gjate zbatimit te kontrates. Ne oferte duhet te percaktohet pjesa e shërbimit, punes ose furnizimit, qe do te kryeje secili nga anëtarët e ketij bashkimi nepermjet nje kontrate bashkepunimi te hartuar ndermjet palëve. Anëtarët e bashkimit te operatorive ekonomike caktone ne kontraten e bashkëpunimit ndermjet tyre perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo kontrate bashkepunimi duhet te dërgohet se bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet te nënshkruhet nga perfaqesuesi. Perfaqesuesi duhet te beje edhe sigurimin e ofertes, duke specifikuar pjesëmarrjen ne bashkimi e operatoreve ekonomike. Secili prej anetarive te ketij bashkimi duhet te permbushë kërkesat e parashikuara ne nenin 76, te LPP-se, dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kërkesat per kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyren e pjesëmarrjes ne pune, shërbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarreveshje. Ne aktmarreveshjen e bashkepunimit Nr. rep 983 date 14/05/2025 mes shoqërisë NELSA SHPK dhe shoqërisë EL-GJO-2006 SHPK pika 4/1 thuhet: Shoqeria EL-GJO 2006 Shpk do te kryeje blerjen e mallrave objekt prokurimi ne emër dhe per llogari te bashkimit te operatoreve sipas kontrates se furnizimit te deklaruar dhe te dorezuar ne SPE, si dhe do te kryeje raport analizat e kerkuara ne dokumentat e tenderit per këto produkte.

Referuar rregullave te prokurimit publik, ne kontraten e bashkepunimit operatorët ekonomike nuk duhet te ndajne kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor duke percaktuar se cilat kriterë do te plotesojë cdo anetar i bashkimit, por duhet te ndajne dhe percaktojnë elementet konkrete te furnizimit qe do te kryeje secili referuar zerave te preventivit dhe sasive qe kerkon autoriteti kontraktor.

Sa me siper, permbushja e kriterëve dhe kërkesave te autoritetit kontraktor duhet te behet nga secili anëtar i bashkimit ne perputhje me perqindjen e furnizimeve te marra persiper. Duke qene se secili prej anetareve te bashkimit te operatoreve ka marre persiper te kryeje nje perqindje te caktuar te totalit te furnizimit, K.SH.A gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomike Nelsa sh.p.k dhe EL-GJO-2006 sh.p.k. nuk është ne perputhje me kërkesat e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, pasi

kerkesa per fleteanaliza plotesohet vetem nga operatori ekonomik EL-GJO-2006 sh.p.k. i cili ka marre persiper 90% te vleres total te furnizimeve, ndersa nga operatori Nelsa sh.p.k nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion i tille, qe duhej te ishte plotsuar referuar perqindjes se marre persiper. Kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per t'u permbushur nga te gjitha ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Operatoret ekonomike pjesemarres duhet te vertetojne se zoterojne reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zbatuar kontraten objekt prokurimi. Per sa me siper, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomike Nelsa sh.p.k dhe EL-GJO-2006 sh.p.k. ne kete procedure prokurimi, nuk ploteson kerkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund te konsiderohet i vlefshem. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personeline nevojhen, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per t'u permbushur nga te gjitha ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Operatoret ekonomike pjesemarres duhet te vertetone se zoterojne reputacionin, besueshmerine, pervojen e e duhur dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten objekt prokurimi, si edhe jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit, ne menyre qe edhe vleresimi te behet ne perputhje me këtë dokumentacion. Mosplotesimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e ben ofertën e operatorit ekonomik te pavlefshme.

Ne lidhje me këte pike, arsyet e skualifikimit te bera nga KVO qendrojne dhe jane te mbeshtetura ne LPP dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e regullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ne perfundim te shqyrtimit te ankeses vleresojme se pretendimet e paraqitura nga shoqeria EL-GJO-2006 Shpk nuk qendrojne ndaj perben shkak per mospranimin dhe refuzimin e ankeses nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen se: “1- Kontrata e bashkepunimit mes paleve nr.983 rep date 14.05.2025 nuk është bere ne respektim te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatoreve ekonomike”, pika 1 ku thuhet: Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve, pasi ne kontraten e bashkepunimit është bere vetem ndarja ne perqindje 10% me 90% ndermjet subjekteve por nuk jane percaktuar elementet konkrete pasi nuk është percaktuar se cilet artikuj konkretisht merr persiper te furnizojë njera pale dhe pala tjetër pjesë e akt/marrëveshjes. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimi ku ne faqen e dyte parashikohet “Nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatoresh Ekonomike, do te paraqitet marrreveshje bashkepunimi ku caktohet.....dhe elementet qe merr persiper secili prej anetareve te bashkimit”. 2- Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit te shoqerise Nelsa është deklaruar ne seksionin e subjekteve mbeshtetes shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k e cila ne dokumentat e tenderit është deklaruar si anetare e bashkimit te operatoreve duke mos plotesuar keshtu kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e sakta më sipër sic ky formular parashikon. Ky rregull paraqitet qarte ne kriteret e pergjithshme te pranimi ku ne faqen e dyte rreshti i pare theksohet se “Ne rast bashkimi te operatoreve , secili anetar i grupit duhet te paraqese Vetedeklarimin e lartpermendur”, si dhe me poshte “Nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatoresh Ekonomike, do te paraqitet marrreveshje bashkepunimi ku caktohet perfaqesuesi, perqindja e pjesmarrjes ne bashkim....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rastë]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

III.1.3. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit

1. Ofertuesi Duhet Të Paraqesë:

A. Formularin Përmbledhës Të Vetëdeklarimit, Sipas Shtojcës 9;

III.1.4. Në përmbushje të kriterit më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK kanë dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 14.05.2025, me Nr. Rep 983 dhe Nr. Kol 560 midis operatorit ekonomik “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK. Sipas nenit 2, objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohëshëm të shoqërive për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurën e prokurimit, “E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Mjete Elektronike që organizon autoriteti kontraktor “Bashkia Shkodër” në datë 15.05.2025 me objekt “Blerje e artikujve ushqimorë” me fond limit: 22.354.848 lekë pa TVSH me Nr. Ref-44826-04-12-2025. Në nenin 4 të kësaj kontrate pjesëmarrja janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Nelsa” SHPK do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurim, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi si edhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësve të nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Transportimi i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kryejë blerjen e mallrave objekt prokurimi në emër dhe për llogari të bashkimit të operatorëve sipas kontratës së furnizimit të deklaruar dhe të dorëzuar në SPE si dhe do të kryejë raport analizat e kërkuara në dokumentat e tenderit për këto produkte. Shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë pjesëmarrje do të kontribuojnë edhe me kapacitetin teknik, financiar të cilat do të vendosen në dispozicion për të përmbushur plotësisht objektin e kontratës. Bazuar në këtë kontratë lidhur mes palëve 10 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” SHPK ndërsa 90 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “El Gjo 2006” SHPK.

1- Shtojcën 1 Formularin e Ofertës Ekonomike” bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK deklaron:

Shtojca 1.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹****Data:** 15/05/2025**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** REF-44826-04-12-2025**Për:** [Bashkia Shkoder]**Emri i ofertuesit dhe NIPT-i** [El Gjo 2006/ J66902033R & Nelsa/ J71601012S]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: [Blerje e artikujve ushqimorë], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne [El Gjo 2006/ J66902033R & Nelsa/ J71601012S], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [Blerje e artikujve ushqimorë].

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor [Bashkia Shkoder], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [15884000-815894210-6] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: **19,395,650** [nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë];

1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “El Gjo 2006” SHPK. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik”, gërma “A”: operatori ekonomik “El Gjo 2006” SHPK deklaroi:

Unë i nënshkruari **Greta Rrathtori** në cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik **El-Gjo 2006** deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	1. El – Gjo – 2006 sh.p.k (sipas akt marreveshjes dhe prokures bashkelidhur) 2. Nelsa shpk (sipas akt marreveshjes dhe prokures bashkelidhur)
Numri NIPT-et:	1. J66902033R 2. J71601012S
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	1. Rruga Ingj.Gjovalin Gjadri, 14/202, Zona Kadastrale 8593 bashke me magazinën 30 m2, Kodi postar 4001, Shkoder, Shkoder 2. Tirane, Dajt, Lagjia Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1
Përfaqësuesi (emri):	---
Telefoni:	1. --- 2. ---
E-mail:	1 --- 2 ---

2- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Nelsa” SHPK. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik”, gërma “A”: operatori ekonomik “Nelsa” SHPK deklaroi:

- I. Unë i nënshkruari **Elsa KAMBERI** në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik “NELSA” SHPK deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	1. Nelsa shpk (sipas akt marreveshjes dhe prokures dorezuar ne SPE) 2. EI – Gjo – 2006 shpk (sipas akt marreveshjes dhe prokures dorezuar ne SPE)
Numri NIPT/et:	1. Nelsa shpk : J71601012S 2. EI – Gjo – 2006 sh.p.k: J66902023R
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Nelsa shpk: Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt/Tirane Kodi Postar: 1001 EI – Gjo – 2006 sh.p.k: Rruga Qyteti / qyteti; Kodi postar Ingj.Gjovallin nr.pasurie Gjadri, 14/202, Zona Kadastrale 8593 bashke me magazinën 30 m2, Kodi postar 4001, Shkoder, Shkoder
Përfaqësuesi (emri):	Nelsa shpk: EI-GJO 2006 Shpk:
Telefoni:	Nelsa shpk: EI-GJO 2006 Shpk:
E-mail:	Nelsa shpk: EI-GJO 2006:

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.6. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor,

social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.8. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të*

gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...

III.1.9. Në nenin 88 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

4.1. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të

bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.11. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Komisioni konstaton se oferta me numër: OFFER-4031/13052025, datë 15.05.2025 është aplikuar dhe dorëzuar në këtë sistem për këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, oferta si bashkim operatorësh ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, vërtetuar kjo jo vetëm nga verifikimi i formularit të ofertës por edhe shtojcës 8 formulari përmbledhës i vetëdeklarimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorit ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, Komisioni konstaton se është dorëzuar edhe dokumentit *Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 14.05.2025, me Nr. Rep 983 dhe Nr. Kol 560*, sipas parashikimeve të nenit 88 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” pika 2 dhe 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Për më tepër, Komisioni konstaton se në dokumentacionin e ofertës është dorëzuar nga ana e ofertuesit “El Gjo 2006” SHPK dhe “Nelsa” SHPK Shtojca 9 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, ku në Seksionin A “*Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik*” secili nga anëtarët e bashkimit ka deklaruar se ka ofertuar si bashkim operatorësh ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik referuar legjislacionit në fushën e prokurimit publik vëren se, ligji 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” parashikon se grupe të operatorëve ekonomikë, në një procedurë prokurimi dorëzojnë oferta si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore të paraqitjes së ofertave, përse kohë nuk është parashikuar një formë e tillë në DST për bashkimin e operatorëve ekonomikë në kuptim të

prashikimeve të nenit 14 pika 2 të *lex specialis*. Gjithashtu në nenin 88, të VKM-së anëtarët e BOE përcaktojnë në marrëveshjen e tyre përgjegjësitë dhe detyrat që do të kryejnë secili në këtë bashkim. Në rastin konkret operatorët ekonomikë në këtë BOE marrin përsipër në përputhje me kapacitetet e tyre, elementë të caktuar të kontratës me qëllimin final të relizimit të saj me sukses.

Referuar dokumentacionit të tenderit, shtojcave përkatëse, vërehet se AK ka parashikuar shtojcat 1/1, Formularin e Ofertës dhe shtojcën 2, Lista e çmimeve, si formate për t'u paraqitur si nga operatorët ekonomike të cilët ofertojnë të vetëm në këtë procedurë prokurimi ashtu edhe nga BOE, pra pa specifikuar një formë të veçantë të praqitjes së ofertës me të cilën ofertojnë subjektet si pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Ankimuesi BOE "El Gjo 2006" SHPK dhe "Nelsa" SHPK, në përmbushje të shtojcës 1/1 ka paraqitur ofertën ekonomike bashkëlidhur së cilës ka listuar zërat e kërkuar me vlerat përkatëse. Me të drejtë ankimuesi ngre pretendimet e tij dhe i argumenton me sqarime se BOE nëpërmjet Kontratës së Bashkëpunimit (*Për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë*) midis palëve në këtë BOE ka përcaktuar qartë ndarjen proporcionale të dy shoqërive në këtë kontratë, rolet, të drejtat dhe detyrat, përgjegjësitë e secilit operator ekonomik në këtë bashkim të përkohshëm, të cilët marrin përsipër të realizojë detyrat sipas ndarjeve që ata kanë përcaktuar në mënyrë të qartë, me qëllim realizimin e kontratës në kohë dhe me cilësinë e kërkuar në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se oferta ekonomike e paraqitur nga ankimuesi është e rregullt dhe në përputhje me formatet dhe përmbajtjen e kërkuar në DST të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.12. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementet që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit". Në përmbushje të saj, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar në SPE *Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 14.05.2025, me Nr. Rep 983 dhe Nr. Kol 560 midis operatorit ekonomik "El Gjo 2006" SHPK & "Nelsa" SHPK. Sipas nenit 2, objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohshëm të shoqërive për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurën e prokurimit, "E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Mjete Elektronike që organizon autoriteti kontraktor "Bashkia Shkodër" në datë 15.05.2025 me objekt "Blerje e artikujve ushqimorë" me fond limit: 22.354.848 lekë pa TVSH me Nr. Ref-44826-04-12-2025. Në nenin 4 të kësaj kontrate pjesëmarrja janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria "Nelsa" SHPK do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurim, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Shoqëria "El Gjo 2006" SHPK do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi si edhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësve të nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Transportimi i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëria "El Gjo 2006" SHPK do të kryejë blerjen e mallrave objekt prokurimi*

në emër dhe për llogari të bashkimit të operatorëve sipas kontratës së furnizimit të deklaruar dhe të dorëzuar në SPE si dhe do të kryejë raport analizat e kërkuara në dokumentat e tenderit për këto produkte. Shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë pjesëmarrje do të kontribuojnë edhe me kapacitetin teknik, financiar të cilat do të vendosen në dispozicion për të përmbushur plotësisht objektin e kontratës. Bazuar në këtë kontratë lidhur mes palëve 10 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” SHPK ndërsa 90 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “El Gjo 2006” SHPK. Referuar kontratës së bashkëpunimit konkretisht nenit 4 të saj si dhe arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, rezulton se nuk qëndron, pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar një kontratë bashkëpunimi ku ka evidentuar, palët edhe kontributet e tyre të shprehura jo vetëm në përqindje, ashtu siç është kërkuar dhe në dokumentet e tenderit ku duhet përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes në bashkim por në nenin 4 të saj janë përcaktuar edhe elementët që do të marrë përsipër dhe do të realizojë secila palë në bashkëpunim. Në asnjë rresht të dokumenteve të tenderit apo kriter për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kontrata e bashkëpunimit midis palëve të ketë të eviendruar përveç përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementet që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit edhe vlerën e shërbimit. Në kuptim të sa më sipër, në marrëveshjen e bashkëpunimit të ngarkuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes janë përcaktuar qartë përqindja pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit, si edhe elementët konkretë që do të kryejë secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në marrëveshjen e bashkëpunimit, ashtu siç edhe përcaktohet në legjislacionin në fuqi, përcaktohen të gjitha të dhënat sic janë përqindja e bashkëpunimit si edhe zërat/elementët konkretë që do të marrë përsipër për të kryer secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK dhe “Nelsa” SHPK, ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me dokumentat e tenderit dhe nenin 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik

ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: *“Ne formularin përmbledhës të vetdeklarimit të shoqërisë Nelsa sh.p.k është paraqitur vetëm një mjet jo frigoriferik ATO me targa AA 978 KU dhe nuk është deklaruar mjeti frigoriferik sipas kërkesave të DST ku ofertuesit duhet të disponojnë 2 (dy) mjete APV dhe ATP kjo gjë bie në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3 ku thuhet: Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Pra sic parashikohet në piken 2.3.7 “Subjekti ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontratës noteriale...2 mjete APV dhe ATP...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.7 të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se është kërkuar si vijon:

Subjekti ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontratës noteriale të qerash, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, 2 (dy) mjete transporti të përshtatshme për transportin e produkteve ushqimore, të shoqëruar me leje qarkullimi, police sigurimi, akt kolaudimi, foton perkatese si dhe lejen higjieno-sanitare, ku njëri prej tyre të jetë ATP (frigorifer) ndërsa tjetri mjet ATV.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, për përmbushjen e kriterëve të sipërcituara ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike SPE dokumentat si vijon:

1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “El Gjo 2006” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” operatori ekonomik “El Gjo 2006” SHPK deklaron:

B: DEKLARATË**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
	Po ☒ Jo ☐
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Nëse, po, numri i punonjësve:
	<u>Profili i punonjësve (Nuk kërkohet)</u>
	<u>Makineri e mjete</u>
	Po ☒ Jo ☐
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
	1. Mjet transporti me kapacitet mbajtes ngarkese 360 kg, me leje qarkullimi me targa me nr.shasie ngjyra e bardhe 2. Mjet transporti ATP me kapacitet mbajtes ngarkese 569 kg, me leje qarkullimi me targa me nr.shasie ngjyra e bardhe

2- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Nelsa” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” operatori ekonomik “Nelsa” SHPK deklaron:

B: DEKLARATË**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po ☒ Jo ☐
	Nëse, po, numri i punonjësve:
	Muaji Prill 2025: 19 punonjes
	<u>Profili i punonjësve</u>
	- Nuk kërkohen në DST
	<u>Makineri e mjete</u>
	Po ☒ Jo ☐
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
	1. Mjet jo frigoriferik me targe , --- dhe nr.shasie: V --- (Ne pronesi)
Emri, Mbiemri: Elsa KAMBERI	
Firma _____	
Vula _____	
Data e dorëzimit të deklaratës: 15.05.2025	

- Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 14.05.2025, me Nr. Rep 983 dhe Nr. Kol 560 midis operatorit ekonomik “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK. Sipas nenit 2, objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohëshëm të shoqërive për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurën e prokurimit, “E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Mjete Elektronike që organizon autoriteti kontraktor “Bashkia Shkodër” në datë 15.05.2025 me objekt “Blerje e artikujve ushqimorë” me fond limit: 22.354.848 lekë pa TVSH me Nr. Ref-44826-04-12-2025. Në nenin 4 të kësaj kontrate pjesëmarrja janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Nelsa” SHPK do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurim, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi si edhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësve të nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Transportimi i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kryejë blerjen e mallrave objekt prokurimi në emër dhe për llogari të bashkimit të operatorëve sipas kontratës së furnizimit të deklaruar dhe të dorëzuar në SPE si dhe do të kryejë raport analizat e kërkuara në dokumentat e tenderit për këto produkte. Shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë pjesëmarrje do të kontribuojnë edhe me kapacitetin teknik, financiar të cilat do të vendosen në dispozicion për të përmbushur plotësisht objektin e kontratës. Bazuar në këtë kontratë lidhur mes palëve 10 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” SHPK ndërsa 90 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “El Gjo 2006” SHPK.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me

qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.2.5. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...

III.2.7. Në nenin 88 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

4.1. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.

III.2.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.2.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

III.2.10. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.2.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetohet, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike/ të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.12. Nisur nga pretendimet më sipër të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, për skualifikimin e tyre, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) ankimues, në rastin konkret, nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, i cili ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, dhe nga operatori ekonomik “El Gjo 2006” SHPK, i cili ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e pikës 2.3.7 në kriteret e vecanta të kualifikimit kanë kryer deklaratimet si në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në rastin konkret, kemi një bashkim operatorësh ekonomikë, të cilët kanë nënshkruar një *kontratë bashkëpunimi e lidhur më datë 14.05.2025, me Nr. Rep 983 dhe Nr. Kol 560 midis operatorit ekonomik “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK. Sipas nenit 2, objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohëshëm të shoqërive për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurën e prokurimit, “E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Mjete Elektronike që organizon autoriteti kontraktor “Bashkia Shkodër” në datë 15.05.2025 me objekt “Blerje e artikujve ushqimorë” me fond limit: 22.354.848 lekë pa TVSH me Nr. Ref-44826-04-12-2025. Në nenin 4 të kësaj kontrate pjesëmarrja janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Nelsa” SHPK do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurim, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi si edhe vë në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësit e nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Transportimi i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kryejë blerjen e mallrave objekt prokurimi në emër dhe për llogari të bashkimit të operatorëve sipas kontratës së furnizimit të deklaruar dhe të dorëzuar në SPE si dhe do të kryejë raport analizat e kërkuara në dokumentat e tenderit për këto produkte.*

Për makineritë dhe pajisjet, e deklaruar sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, provohet disponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi dhe konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9, pasi në kriterin 2.3.7 të

dokumentave standarte të procedureës objekt shqyrtimi nga ana e autoritetit është kërkuar disponimi i dy mjeteve të transportit ku njeri prej tyre të jetë ATP (frigorifer) ndërsa tjetri mjet ATV, nga verifikimi i kontratës së bashkëpunimit të sipërcituar rezulton se pjesëmarrja është ndarë 10 % me 90 %, referuar deklarimeve në shtojcën 9 rezulton se është deklaruar nga anëtarët i bashkimit “Nelsa” SHPK disponimi i një mjeti ATP frigoriferik me të dhenat e mjetit dhe nga ana e anëtarit “El Gjo 2006” SHPK disponimi i dy mjeteve njëri mjet ATP dhe tjetri ATV me të dhenat e mjetit. Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, më datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Për më tepër, neni 4 i kontratës së bashkëpunimit, është përcaktuar, [.., ku shoqëria “Nelsa” SHPK do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurim, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi si edhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësve të nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Transportimi i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kryejë blerjen e mallrave objekt prokurimi në emër dhe për llogari të bashkimit të operatorëve sipas kontratës së furnizimit të deklaruar dhe të dorëzuar në SPE si dhe do të kryejë raport analizat e kërkuara në dokumentat e tenderit për këto produkte....].

III.2.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme

me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme, të kërkesave për kualifikim, për disponimin e makinerive si - një makinë ATP; - një makinë ATV, të nevojshme për të kryer transportin e produkteve ushqimore, deri në realizimin e plotë të saj, të cilat janë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga subjekti “Nelsa” SHPK në masën 10 % dhe subjekti “El Gjo 2006” në masën 90 % dhe konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9, për fazën e vlerësimit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.7 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, në përputhje me natyrën e pjesëmarrjes në furnizimin e mallit objekt prokurimi dhe natyrës së shërbimit, të përcaktuar në aktmarrëveshje, midis palëve.

Vlen të theksojmë, se në çdo rast është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, të kërkojë nga operatori ekonomik që të vërtetojë përmbushjen e kriterëve kualifikues dhe specifikimeve teknike. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK qendron.

III.3. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: *“Shoqeria Nelsa nuk ka paraqitur flete analiza ne raport me perqindjen e pjesemarrjes ne bashkimin e operateve ekonomike pamvaresisht faktit se ne kontraten e bashkepunimit thuhet se fleteanalizat realizohen nga shoqeria El-Gjo 2006 sh.p.k. por kjo gje bie ne kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operateve ekonomike”, pika 3 ku thuhet: Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes*

në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4 të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se është kërkuar si vijon:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport-analiza origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës i vitit 2025 për artikujt që prokurohen.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, për përmbushjen e kriteve të sipërcituara ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike SPE dokumentat si vijon:

- Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 14.05.2025, me Nr. Rep 983 dhe Nr. Kol 560 midis operatorit ekonomik “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK. Sipas nenit 2, objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohëshëm të shoqërive për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurën e prokurimit, “E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Mjete Elektronike që organizon autoriteti kontraktor “Bashkia Shkodër” në datë 15.05.2025 me objekt “Blerje e artikujve ushqimorë” me fond limit: 22.354.848 lekë pa TVSH me Nr. Ref-44826-04-12-2025. Në nenin 4 të kësaj kontrate pjesëmarrja janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Nelsa” SHPK do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurim, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi si edhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësve të nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Transportimi i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kryejë blerjen e mallrave objekt prokurimi në emër dhe për llogari të bashkimit të operatorëve sipas kontratës së furnizimit të deklaruar dhe të dorëzuar në SPE si dhe do të kryejë raport analizat e kërkuara në dokumentat e tenderit për këto produkte. Shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë pjesëmarrje do të kontribuojnë edhe me kapacitetin teknik, financiar të cilat do të vendosen në dispozicion për të përmbushur plotësisht objektin e kontratës. Bazuar në këtë kontratë lidhur mes palëve 10 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” SHPK ndërsa 90 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “El Gjo 2006” SHPK.

- Raport-analiza.

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.3.5. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
- 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.
Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.
Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.
- 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.3.6. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurëojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.8. Në nenin 88 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

4.1. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim

sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.

III.3.9. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.3.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të

vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike/ të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.3.11. Nisur nga pretendimet më sipër të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, për skualifikimin e tyre, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) ankimues, në rastin konkret, referuar kontratës bashkëpunimi e lidhur më datë 14.05.2025, me Nr. Rep 983 dhe Nr. Kol 560 midis operatorit ekonomik “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK. Sipas nenit 2, objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohëshëm të shoqërive për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurën e prokurimit, “E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Mjete Elektronike që organizon autoriteti kontraktor “Bashkia Shkodër” në datë 15.05.2025 me objekt “Blerje e artikujve ushqimorë” me fond limit: 22.354.848 lekë pa TVSH me Nr. Ref-44826-04-12-2025. Në nenin 4 të kësaj kontrate pjesëmarrja janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Nelsa” SHPK do të kontribuojë në total në masën 10 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet objekt prokurim, si edhe vë në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe një mjet për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kontribuojë në total në masën 90 % në këtë pjesëmarrje, duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet objekt prokurimi si edhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme si dhe punonjësve të nevojshëm për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi. Transportimi i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëria “El Gjo 2006” SHPK do të kryejë blerjen e mallrave objekt prokurimi në emër dhe për llogari të bashkimit të operatorëve sipas kontratës së furnizimit të deklaruar dhe të dorëzuar në SPE si dhe do të kryejë raport analizat e kërkuara në dokumentat e tenderit për këto produkte.

Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se objekti i prokurimit të procedurës objekt - ankimi është furnizim me produkte ushqimore dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit konkretisht në pikën 2.3.4 ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin raport analizat nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës i vitit 2025 për artikujt që prokurohen. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, rezulton se anëtari i bashkimit të operatorëve “El Gjo 2006” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përmbushje të kriterit 2.3.4. të dokumenteve të tenderit në pikën III.3.2. raport analizat të lëshuara nga laboratori ECM Studio për produktet ushqimore sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e

rëndësishme të provohet që operatori ekonomik ka dorëzuar raport analizat sipas kërkesës në DST. Nga shqyrtimi i kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar në mënyrë eksplicite raport analizat nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës i vitit 2025 për artikujt që prokurohen. Referuar aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, konstatohet se në nenin 4 të saj është ndarë dhe pjesëmarrja nga ku konstatohet se kryerja e raport analizave është marrë përsipër nga ana e anëtarit të bashkimit të operatorëve “El Gjo 2006” SHPK.

Sa më sipër, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike raport analizat e lëshuara nga laboratori ECM Studio sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe sipas përcaktimeve të bëra nën nenin 4 të kontratës së bashkëpunimit të sipërcituar ashtu sikurse është kërkuar nga autoriteti kontraktor pasi referuar edhe pikës 3 të nenit 88 të LPP. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në këtë kuptim KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon raport analizave të lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës i vitit 2025 për artikujt që prokurohen, të cilat në referim të nenit 4 të kontratës së bashkëpunimit të sipërcituar janë marrë përsipër të realizohen nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK, dhe jo nga anëtari tjetër i BOE “Nelsa” SHPK sikurse pretenon autoriteti kontraktor..

III.3.12. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme, të kërkesave për kualifikim, për disponimin e raport analizave për produktet ushqimore të cilat janë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga subjekti “El Gjo 2006” SHPK. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.4 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, në përputhje me natyrën e pjesëmarrjes në furnizimin e mallit objekt prokurimi dhe natyrës së shërbimit, të përcaktuar në aktmarrëveshje, midis palëve.

Vlen të theksojmë, se në çdo rast është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, të kërkojë nga operatori ekonomik që të vërtetojë përmbushjen e kriterëve kualifikues dhe specifikimeve teknike. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet

e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe nenit 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-44826-04-12-2025, me objekt: “Blerje e artikujve ushqimorë”, me fond limit 22,354,848 (njëzet e dy milion e treqind e pesëdhjetë e katërmijë e tetëqind e dyzet e tetë) lekë pa tvsh, ose 224,739.59 (dyqind e njëzet e katërmijë e shtatëqind e tridhjetë e nënte pikë pesëdhjetë e nentë) Euro, zhvilluar më datë 15.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK, të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke e kualifikuar këtë BOE, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje me zbatimin e konstatimeve të mësipërme.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “El Gjo 2006” SHPK & “Nelsa” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

